



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE  
DHE EKONOMISË

INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE  
DREJTORIA RAJONALE E ISHPSHSH, RAJONI TIRANË  
SEKTORI DURRËS

Nr. 4377 / Prot.  
18

Tiranë, më 14/11/2022

**Lënda:** Shpallje për subjektin SANARIX, me NIPT L92420009B

**DREJTUAR: SUBJEKTIT SANARIX, ME NIPT L92420009B**

Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore Tiranë, Rajoni I ka kryer inspektim në subjektin SANARIX, me nipt L92420009B në adresë Lagja nr;3, Rruga Egnatia, Durrës dhe në përfundim të procesit të inspektimit në mbështetje të ligjit 9634, datë 30.10.2006 “Për inspektimin në Punë” i ndryshuar, është marrë vendimi përfundimtar i inspektimit me nr. ISHPSHSH-TR-2022-003658 datë 21.10.2022, ku ndaj subjektit është ndërmarrë masë administrative “Paralajmërim”.

Në zbatim të procedurave që parashikon ligji 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” njoftimi i subjektit për këtë Vendim Përfundimtar nuk është bërë e mundur të kryhet nëpërmjet dorëzimit personal dhe me postë.

Bazuar në nenin 162 i Ligjit Nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, Drejtoria Rajonale e ISHPSHSH Tiranë Rajoni I ka vendosur njoftimin e subjektit “SANARIX,” me nipt dhe adresë L92420009B ,Lagja nr; 3,Rruga Egnatia,Durrës për njohjen me këtë Vendim Përfundimtar të Inspektimit me anë të shpalljes së këtij njoftimi duke e afishuar në zyrat e ISHPSHSH-së, në adresën e subjektit ku është ushtruar inspektimi; në QKB dhe në Bashkinë Durrës, në mjediset e Drejtorisë Qëndrore të ISHPSHSH-së dhe në faqen zyrtare ëeb të ISHPSHSH-së.

Në zbatim të pikës 3 të nenit 162 të Kodit të Procedurës Administrative njoftimi do të vlerësohet për tu kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes. Kundër Vendimit Përfundimtar subjekti “Sanarix” ka të drejtën e ankimimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimim paraqitet pranë ISHPSHSH-së në nivel Qëndror të “Komisioni Ankimimit” të ISHPSHSH-së.

Me përmbajtjen e plotë të Vendimit Përfundimtar të inspektimit dhe marrjen e kopjes mund të paraqiteni pranë ISHPSHSH-së Tiranë dhe njoftimi shpallet sot më datën 11/11/2022 dhe do të qëndroj i afishuar deri më datë 21/11/2022.

**KRYEINSPEKTOR RAJONAL**

**Ardit Shabanaj**

